

**Dr. Diana Kalaja**

**Diskutim mbi programacionin e operatorëve  
televizivë lokalë në Shqipëri**

**Abstract: TV program in the Albanian local TV  
channels**

TV programming in the local television in Albania reflect the uncertain development status these local televisions are going through. They are in the eve of analogue switch off and start broadcasting in the digital format. How will they cope with this new way of broadcasting? Will that have an impact on their programming schedule? How is their programming compared to the programming of the national and regional media?

The paper will try to address all these issues through a comparing analysis and statistical data on some of the selected local TV.

**Keywords:** local television, programming schedule, analog switch off television, public television

### **1. Rigjetja e programit dhe shërbimi ndaj audiencave - detyra “e re” për televizionet lokale në transmetimet dixhitale**

Në prag të kalimit në transmetime digjitale tërësore dhe fikjes graduale të transmetimeve analoge, televizionet lokale përballen më një sërë problematikash që lidhen si me burimet e financimit, transferimit teknologjik, menaxhimin e ndryshimin e përmbajtjes programore dhe rigjetjen e audiencave të tyre.

Ndërtimi i rrjeteve të televizionit publik të transmetimeve dixhitale do t'i strehojë televizionet lokale në këtë platformë që shikuesit teknikisht ta kenë mundësinë ta marrin programin e tyre. Por çfarë do të mund të ofrojnë këto kanale në shumëllojshmërinë e transmetimeve dhe platformave që do të ekzistojnë? Avantazhet konkurruese të këtyre televizioneve lokale do të përcaktohen nga një konkurrencë e fortë, jo vetëm me TV lokale të tjera në zonat e tyre, me televizionet me shtrirje kombëtare, por tashmë me transmetimet dixhitale edhe nga programet që ofrohen nga “paketuesit” e programeve, që nuk janë të lidhur me prodhimin televiziv dhe i ofrojnë këto programe edhe përmes kanaleve të tjera teknologjike, siç është interneti, mobile TV, etj. Ndërkohë këto televizione lokale ende e kanë të paqartë modelin e biznesit që televizionet e tyre, shumë shpejt vetëm në transmetime dixhitale do të duhet të ndjekin.

Përmbajtja programore, burimet e financimit dhe konkurrenca janë tiparet e medias lokale që do të analizohen më poshtë.

### **2. Përmbajtja programore dhe prioritetet e së ardhmes**

Pavarësisht nëse shtrirja e transmetimeve televizive dixhitale në Shqipëri do të ketë një ritëm të ulët apo të shpejtë të


saj, parë nga këndvështrimi i konsumatorit, diskutimi është se cila do të jetë përmbajtja që do të ofrojë kjo teknologji e re.

Çështja e përmbajtjes nuk është një çështje e lidhur vetëm me televizionet lokale, por edhe me të gjitha TV me shtrirje kombëtare dhe rajonale. Por për televizionet lokale, kjo çështje bëhet edhe më e mprehtë për shkak të përballjes së audiencave që ato kishin deti tani, me një buqetë programesh gjithnjë e më të zgjeruar.

Në një vështrim të shpejt të strukturave programore të disa televizioneve lokale, të dhënat statistikore për muajin nëntor 2016 japin një diapazon shumë të ndryshëm të programeve që ato ofrojnë.

### Grafik 1: B. TV, Struktura e programacionit nëntor 2016


<sup>1</sup>(në % ndaj totalit të programit si mesatare javore)



<sup>1</sup>Studim individual i autores, përllogaritje e minutazhit sipas të dhënave të programeve, nëntor 2016. Të dhënat i përkasin një televizioni lokal në pjesën veriore të vendit, por përdoren më shumë si tipologji e një grupi të televizioneve lokale.

**Grafik 2: V. TV, Struktura e programacionit nëntor 2016**


<sup>2</sup>(në % ndaj totalit të programit si mesatare javore)



<sup>2</sup> Studim individual i autores, përlogaritje e minutazhit sipas të dhënave të programeve, nëntor 2016. Të dhënat i përkasin një televizioni lokal në pjesën jugore bregdetare të vendit, qytet ku ky TV lokal nuk është i vetëmi në transmetim. (Struktura është e ngjashme edhe në qytete të tjera të mëdha).

<sup>3</sup> Studim individual i autores, përlogaritje e minutazhit sipas të dhënave të programeve, nëntor 2016. Të dhënat i përkasin një televizioni lokal në pjesën jugore bregdetare të vendit, qytet ku ky TV lokal nuk është i vetëmi në transmetim.

**Grafik 3: S. TV , Struktura e programacionit nëntor 2016 <sup>3</sup>**  
(në % ndaj totalit të programit si mesatare javore)




Programacionet e mësipërme, janë zgjedhur si më tipiket ndër televizionet lokale dhe për këtë arsye se ato karakterizojnë një tipologji të ngjashme me zona të tjera të vendit. Në përgjithësi programacionet ndahen në ato që kanë një kategori prodhimesh të vetat ku përfshihen vetëm lajmet lokale, apo kanë edhe prodhime të tjera.

Nga studimi në tërësi, televizionet karakterizohen nga përqindja mjaft të ulëta të prodhimeve të veta, të cilat sipas një anketimi universitar nuk e kalojnë 30% të programit.<sup>4</sup>

<sup>4</sup>Uni.Beder. 2016. *Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre*. Studim tregu i mbështetur nga "Autoriteti i Mediave Audiovizive", Tiranë: ShL "Hëna e Plotë" (Bedër), faqe 19.

<sup>5</sup>Studim individual i autores, përlllogaritje e minutazhit sipas të dhënave të programeve për disa televizione lokale në vend.

**Grafik 4: Minutazhi mesatar i prodhimit të programeve të veta – pa përfshirë programin e mëngjesit**



E parë nga një këndvështrim më i gjerë për karakteristikat e programacioneve e TV lokale përfshijnë:

1. Përqindje mjaft e ulët e prodhimeve të vetë televizioneve lokale; Ndër TV lokale, jo të gjitha kanë programe të mëngjesit;
2. Disa nga televizionet lokale transmetojnë programet e lajmeve të transmetuesve të huaj siç është “Zëri i Amerikës” apo të tjera, të cilat janë gjithashtu edhe në programin e TVSH, kanal in e parë;
3. Prodhimet e veta, përveç lajmeve përfshijnë në disa raste programe që lidhen me karakteristika të veçanta të qyteteve, rajoneve të cilave ato u përkasin. Në disa nga televizionet kemi programe të tilla si “Koha dhe fermeri”, “Zëri tuaj”<sup>6</sup>, - “Fokus- këndi i qytetarit, “Mjeku në studio”<sup>7</sup>- Gjeografi dhe zakone”, “Peshku dhe midhja jonë”<sup>8</sup>;

<sup>6</sup> TV Apollon Fier, programacioni periudhës shtator – nëntor 2016

<sup>7</sup> TV Onufri Berat, programacioni periudhës shtator – nëntor 2016

<sup>8</sup> Tele Joni TV, programacioni periudhës shtator – nëntor 2016

4. Ka disa televizione që kanë programe në gjuhë të grupeve minoritari, si gjuha Vllehe<sup>9</sup> dhe kjo mund të jetë një mundësi e mirë për të studiuar dhe kapur grupe të veçanta të audiencës;
5. Programacioni është i mbytur nga filmat, në mjaft raste edhe të serialeve dhe telenovelave. Në disa raste këto janë edhe filma shqiptarë të realizuar para viteve ‘90 gjë e cila është problematikë për të tërhequr audiencën në këtë transmetim. Po kështu edhe me këndin e dokumentarëve, ku ka televizione të cilat kanë më transmetim dokumentarët –Heronjtë e Shqipërisë” prodhimi i të cilëve ka përfunduar që në vitin 2008;
6. Disa televizione kanë edhe programe për të rinjtë dhe fëmijët, prodhime të vetë këtyre televizioneve, një avantazh krahasuar me mungesën e këtyre prodhimeve nga TV kombëtare<sup>10</sup>;

### **3. Financimi i televizioneve lokale në epokën dixhitale**

Pikëpyetje të mëdha lidhen me të kuptuarit se cilat do të jenë të ardhurat që do të mund të gjenerojnë përmbajtja e ofruar nga televizionet lokale, kur ajo të përfshihet si paketë për konsumatorët, nën platformat e RTSH si publike, apo nga platforma të tjera të zgjedhur prej tyre. Siç thekson R. Picard, problemi themelor i kompanive të medias si në rastin e atyre me shtrirje kombëtare dhe në ato me shtrirje lokale është pikërisht e lidhur me strukturën programore dhe ofertën për shikuesit ... —

---

<sup>9</sup> TV Apollon Fier, në transmetim ditën e shtunë ora 18 dhe ritransmetim të dielën-programacioni periudhës shtator – nëntor 2016

<sup>10</sup> TV Saranda ka disa programe për fëmijë - programacioni periudhës shtator – nëntor 2016

se shumë nga ata janë duke u përpjekur të shesin produkte e shekullit të 19<sup>-të</sup> dhe 20<sup>-të</sup>, në shekullin e 21<sup>-të</sup>”. (Picard: 2011)

Pronarë dhe menaxherë të televizioneve lokale të intervistuar vazhdojnë të besojnë se reklamat do të jenë burimi kryesor i të ardhurave të tyre<sup>11</sup> (mbi 73% i janë përgjigjur pyetjes se me çfarë burimesh financohet biznesi juaj). Dhe nga studimi i kryer nga Universiteti "Hëna e Plotë" (Bedër), mbi 85% e të intervistuarve, theksojnë se edhe në formë janë reklamat në formatin tradicional ato që sjellin pjesën më të madhe të të ardhurave.<sup>12</sup>

Megjithëse rreth 68% e të gjithë drejtuesve të media pranojnë se ata kanë edhe një tjetër biznes përveç televizionit.<sup>13</sup> Për drejtuesit e mediave në Shqipëri investimet fillestare në teknologjinë dixhitale dhe sistemet e transmetimit janë pjesa më e madhe e kostos në procesin e kalimit në transmetimet dixhitale.

Gjithsesi skepticizmi është karakteristikë e tyre për gatishmërinë në përfshirjen në procesin e dixhitalizimit ndërkohë që më tepër se gjysma e të anketuarve në studim përgjigjen se nuk e dinë këtë përgjigje, ndërsa pjesa më e madhe e atyre që japin një përgjigje thonë se nuk janë të gatshëm për të kaluar në transmetime dixhitale.<sup>14</sup> Kjo është e lidhur edhe me afërsinë apo largësinë që këto televizione kanë me teknologjitë

---

<sup>11</sup> Uni.Beder. 2016. *Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre*. Studim tregu i mbështetur nga "Autoriteti i Mediave Audiovizive", Tiranë: ShL "Hëna e Plotë" (Bedër).

<sup>12</sup>Uni.Beder. 2016. *Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre*. Studim tregu i mbështetur nga "Autoriteti i Mediave Audiovizive", Tiranë: ShL "Hëna e Plotë" (Bedër). Faqe 51

<sup>13</sup> Po aty iranë: ShL "Hëna e Plotë" (Bedër).

<sup>14</sup>Po aty faqe 31



dixhitale në tërësi. Nga pikëpamja teknike, aktualisht pjesa me e madhe e tyre janë të përfshira në platformat kablore se sa me ato të transmetimeve dixhitale.<sup>15</sup>

#### 4. Konkurrenca

Modeli i biznesit televiziv kushtëzohet nga konkurrenca në tregun mediatik, e cila është e ndikuar shumë nga teknologjia, e aq më tepër në kalimin në transmetimet dixhitale. Videot në sitet *online* tani po e konkurrojnë televizionin, sidomos në drejtim të shpejtësisë së transmetimit të informacionit.

Televizionet lokale kanë faqe *online*, por shpesh ajo nuk është e përditësuar dhe në shumicën e rasteve jo interaktive. Nga vëzhgimi i televizioneve lokale vihet re se televizionet lokale ndjejnë më shumë konkurrencën nga njeri tjetri sesa nga televizionet kombëtare. Kjo shihet edhe nga vëzhgimet e programacioneve në qytetet ku ka më shumë se një televizion lokal. Në të tilla qytete, televizionet e kanë më të diversifikuar programin, sjellin llojshmëri dhe ofrojnë më tepër programe lokale se sa televizionet në qytetet ku është vetëm një televizion lokal.

Shumica e operatorëve lokalë e shohin më të pranueshëm variantin e mbështetjes në rrjetet që do të ndërtojë TVSH, duke menduar më shumë për pjesën e mbulimit të shpenzimeve të mbartjes në këto platforma televizive si një detyrim mujor që ata do të duhet të paguajnë.

kur shprehen se –Patjetër mbështetja në rrjetin e RTSh-së, ose me të njëjtat tarifa financiare në një nga rrjetet kombëtare private.

---

<sup>15</sup> Po aty faqe 29

## 5. Përfundime

Përmbajtja e re programore që do të ofrojnë televizionet lokale do të jetë faktori kryesor nxitës për vijueshmërinë dhe ecurinë e biznesit të transmetimeve dixhitale nga televizionet lokale në Shqipëri. Kjo është e nevojshme të kuptohet edhe nga menaxherët dhe pronarët e televizioneve lokale të cilët nevojitet ti ndryshojnë raportet midis gjinive televizive dhe thelbin e përmbajtjes që do të kenë stacionet e tyre televizive.

Ndonëse opinionet ndahen nëse konkurrenca do të ashpësohet duke nxjerrë jashtë tregut televiziv mediat e vogla, apo jo, shprehjet janë se tregu i reklamave do të thërrmohet e ristrukturohet. Sistemi i transmetimit dixhital e ofron me lehtë për këtë matje. Monitorimi i saktë i audiencës, do të duhet të qëndrojë si ndër vendimet e para të autoritetit rregullator audioviziv dhe të ecë paralelisht me licencim e operatorëve televizivë.

### Bibliografi

1. R.G. Picard, *Mapping digital media: Digitalization and media business models*, Open Society Insitute, 2011, fq. 11
2. Uni.Beder. 2016. *Sfidat e transmetuesve lokalë dhe rajonalë përballë qasjes online të shërbimeve të tyre*. Studim tregu i mbështetur nga "Autoriteti i Mediave Audiovizive", Tiranë: ShL "Hëna e Plotë" (Bedër).
3. Programacioni I televizioneve lokale tw Saranda TV, Tele Joni, Lushnja 4 Plus, TV Apollon- Fier, TV Onufri - Berat, TV Glob- Berat, TV Alpo – Gjirokastwr, Antena Nord Shkodwr, Vlora Focus TV, TV Bulqiza.